URDHËR
Nr. 492, datë 22.8.2025

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 483, DATË 31.7.2025, "PËR DELEGIM KOMPETENCE", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", të ndryshuar, të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", të pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore",

URDHËROJ:

1. Në pikën 1 të urdhrit nr. 483, datë 31.7.2025, "Për delegim kompetence", i ndryshuar, bëhet ndryshimi si vijon:

"Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Drejtësisë nga data 19.8.2025–21.8.2025, zëvendësministrit të Drejtësisë, z. Klajd Karameta".

2. Ngarkohet zëvendësministri i Drejtësisë, z.Klajd Karameta, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja